



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIC OF KOSOVO  
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS  
MUNICIPALITY OF KLINA  
OPŠTINA KLINA



[www.komuna-kline.org](http://www.komuna-kline.org)

## Kuvendi i Komunës Klinë

### Komiteti për Politik dhe Financa

01Nr 06-24205/21

Klinë, dt: 27.07. /21

## PROCESVERBAL

Nga mbledhja VI-të e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa, mbajtur, më  
14.06.2021, me fillim nga ora 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Mbledhjen e hapi kryesuesi, z. Fadil Gashi i cili përshëndeti të gjithë, anëtaret e komitetit, drejtoret dhe gjithë të pranishmit, prezantoj rendin e ditës:

- 1 Arsyetimi i mungesave
- 2 Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar
- 3 Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2022-2024
- 4 Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin maj-qershor 2021
- 5 Të ndryshme

Kryesuesi, hapi debat rrëth rendit të ditës, pasi të gjithë u dakorduan për rend dite, kryesuesi vuri në votim rendin e ditës!

**Me 5-të vota PËR u miratua rendi i ditës.**

**Pika 1. Arsyetimi i mungesave.**

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Mungon znj. Vjoleta Zefi dhe Menduhie Duraku të cilat janë arsyetuar se nuk mund të jen sot prezent në mbledhje, ndërsa anëtaret tjerë të gjithë janë prezent.

**Pika 2. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të seancës së kaluar.**

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Nëse ka dikush diçka rrëth procesverbalit nga mbledhja e kaluar, urdhëroni!

**Pasi askush nuk kishte ndonjë vërejtje apo sugjerim kryesuesi hodhi në votim dhe me 5-së vota PËR u miratua procesverbali nga mbledhja e kaluar.**

**Pika 3. Shqyrtimi i Kornizës Afatmesme Buxhetore 2022-2024.**

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Siç e dini edhe ju ne njëherë e kemi kaluar ketë draft seancën e kaluar dhe kemi marrë vendim për shqyrtim publik. Pra nesër e kemi mbledhjen debat me publikun, dhe do ti marrim të gjitha vërejtjet dhe sugjerimet edhe nga qytetaret, pastaj do ti dërgoj në Kuvend. Unë po i jap fjalën z. Ajet Sejdiut nëse ka diçka për të shtuar rrëth kësaj pike.

**Z. Ajet Sejdiu:** Përshëndetje për të gjithë, besoj se të gjithë e keni pranuar ketë draft-kornizë buxhetore dhe nëse ka dikush diçka urdhëroni?!

**Z. Enver Berisha:** Nëse nuk ka pësuar ndonjë ndryshim nga hera e kaluar nuk shoh arsyen për prezantim nga drejtoria.

**Z. Ajet Sejdiu :** Jo është e njëjta ashtu siç ka qenë, por nëse ka dikush ndonjë pyetje unë jam këtu.

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Atëherë nëse ka dikush diçka rrëth kësaj pike urdhëroni?

-Pasi nuk mori fjalën askush, kryesuesi vuri në votim dhe me 5-së vota PËR, KPF, rekomandoj që Korniza Afatmesme Buxhetore 2022-2024, të kaloj për shqyrtim dhe miratim në Kuvend.

**Pika 4. Shqyrtimi i kërkesave të arritura për Komitetin për Politikë dhe Financa për muajin maj-qershor 2021**

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Theksoj se kemi disa kërkesa të cilat kanë arritur për shqyrtim në komitet, besoj se edhe ju tashmë i keni në material. Unë po vazhdoj ti prezantoj me radhë!

### **Kërkesa nr. 1:**

Kërkesë e parashtruar nga Labinot Racaj për dhënie në shfrytëzim të pronës shoqërore në sipërfaqe prej (500m<sup>2</sup>) nga ngastra me Nr.769 e cila gjendët në lagjën Arberia, Qëllimi për shfrytëzimin e kësaj parcele është që të hapet një punëtori për ushtrimin e veprimtarisë-biznesit së gurgdhendës N.T.P “LIRIMI”

-Kryesuesi , nëse edhe ju pajtoheni, edhe kjo kërkesë të trajtohet ashtu si kërkesat e mëhershme të kësaj natyre, unë po hapi debat!

-Pasi të gjithë u pajtuan me propozim nga kryesuesi i komitetit, kryesuesi vuri në votim dhe me 5-së vota PËR, KPF rekomandoj që kërkesa në fjalë të dërgohet për shqyrtim në zyrën e kryetarit, ku do të veprohet sipas Ligjit Nr.06./L-092 Dhe Rregullores (QRK) Nr. 09/2020 për përcaktimin e procedurave të dhënieve në shfrytëzim dhe këmbim të pronës së paluajtshme të komunës.

### **Kërkesa nr. 2:**

Kërkesë e parashtruar nga Jozë Mataj nga fshati Dresnik për shfrytëzimin e pronës me Nr. 006671-0- Z.K Dresnik sipërfaqe prej 528 m<sup>2</sup> për vendosjen e bustit të veprimtarit Gjon Markaquni Mataj i vrarë në vitin 1946.

-Kryesuesi theksoj se mbledhjen e ardhshme i kemi në rishqyrtim tri vendime, vendimin për ndërtimin e shtëpisë së shëndetit në Fshatin Shtupel, vendimin për ndërtimin e sallës nga banoret në fshatin Zajm dhe inicimi për hartimin e planit zhvillimore, prandaj kisha kërkuar mos të ngutemi me marrje të vendimeve pa u konsultuar dhe kompletuar lënda paraprakisht nga drejtorit. Unë propozoj që paraprakisht të rekomandohet në drejtorin e kadastrit dhe drejtorin e urbanizmit, drejtorit në fjalë ta bëjnë një elaborat të detajuar pastaj të marrim vendim në Kuvend.

**Z. Skender Merturi, drejtor i DKRS:** Me sa kam informatë unë, prona është pronë private dhe ata kërkojnë vetëm leje për vendosjen e bustit, sepse kanë qen tek unë në takim dhe kështu ma kanë interpretuar.

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Në kërkesë është e shkruar ndryshe, kërkohet për dhënie në shfrytëzim dhe theksohet se prona është pronë e komunës, ndoshta e kanë shkruar edhe gabim, për ketë arsyë më mirë është që t'i sqarojnë drejtorit.

**Z. Tunë Dedaj:** Përrshëndetje për të gjithë, unë e pashë kërkesën , mendoj se kishte me qenë mirë që ta dërgojmë në Kuvend, duke e marrë parasysh kontributin e të ndjerit është mirë që Kuvendi ta aprovoj qoftë në pronë shoqërore, qoftë private.

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Faleminderit Tunë, Mendoj se ne nuk i ndihmojmë Kuvendit nëse e rekomandojmë kështu pa një elaborat sepse po ndodh mandej dhe po kthehen vendimet në rishqyrtim, unë nuk po e kontestoj, por të jemi të sigurt kur të merret vendimi.

**Z. Enver Berisha:** Unë nuk e kontestoj kërkesën por mos të bëjmë gabime si në të kaluarën, paraprakisht të shikohen nga drejtorit në fjalë dhe vendimet që i marrim të mos kontestohen pastaj. Unë jam pro asaj që kërkesa të analizohet dhe kompletohet nga drejtorit siç e thatë edhe ju kryesues.

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** Në rregull nëse edhe ju pajtoheni, paraprakisht të bëhet një elaborat nga drejtorit për kësaj kërkese mandej të sjellët në Kuvend.

Kryesuesi vuri në votim dhe me 5-së vota PËR, Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që kërkesa të dërgohet në drejtorin e Kadastrit, Gjeodezisë dhe Pronësisë dhe në drejtorinë e Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit. Drejtorit në fjalë të sjellin të gjitha informatat rrethe pronës, procedurën për lejimin e vendosjes së bustit.

**Kryesuesi vazhdoj me prezantimin e kërkeseve të radhës:**

**Kërkesa nr. 3:**

Kërkësë e parashtruar nga Organizata e Veteranëve të Luftës së UÇK-së, dega në Klinë. Kërkësë për mbështetje financiare pasi që duke marrë parasysh aktivitetet e shumta brenda dhe jashtë vendi e që kapin vlerën e shpenzimeve rrëth 4000 Euro në vit vështirë të mbulohen.

**Kërkesa nr.4:**

Kërkësë e parashtruar nga Shoqata e Invalidëve të Luftës së UÇK-së dega në Klinë, kërkësë për mbështetje financiare për mbulimin e shpenzimeve të cilat krijohen nga aktivitetet e shumta dhe mbarëvajtjen e punëve të Shoqatës të cilat arrin vlerën prej 2930 Euro.

**Kërkesa nr. 5:**

Kërkësë e parashtruar nga Shoqata e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së dega Klinë, kërkësë për mbështetje financiare për aktivitetet e Shoqatës gjatë vitit dhe shpenzimet për zyrë të cilat arrin vlerën prej 2710 Euro.

**Kryesuesi**, hapi debat rrëth tri kërkeseve të parashtruara nga shoqatat:

**Z. Skender Merturi, drejtor i DKRS:** Ne si drejtori i kemi analizuar këto kërkesa dhe deri dikun e kanë një arsyeshmëri, por ne nuk kemi mundësi buxhetore t'i përkrahim ashtu siç kanë kërkuar, ne do t'i ndihmojmë me një shumë të cilën do ta ndajmë në Kuvend, nëse Kuvendi pajtohet, d.m.th. Shoqatës së veteranëve do t'ju ndajmë 1500 ndërsa për dy të tjerat për shoqatën e familjeve të dëshmorëve dhe shoqatën e invalidëve me nga 1000 euro për secilën.

**Z. Enver Berisha:** Realisht për mua nuk po qëndron në një aspekt, nëse kërkesa i drejtohet asamblesë, pse duhet të vije diçka si preferencë nga mekanizmat e tjerë si p.sh. nga kryetari! Nëse këto shoqata të gjitha bashkë i kanë kërkuar dhjet mijë euro e ne të ju japim 30000 euro nuk bën, por nëse shoqatat pajtohen se tu jepet shumë tjeter unë pajtohem për ndryshe mos të vije në kuvend fare nëse mendoni ti ndihmoni me atë shumë.

**Z. Ajet Sejdiu:** Ne i kemi ndarë një shumë prej 60.000.00 euro për subvencionimin e klubeve dhe është dashur të veprohet në bazë të rregullores së ministrisë së financave, drejtori e din se si janë ndarë dhe a ka mjete për të shtuar nga ajo shumë, për ndryshe rregullorja e determinon shumë mirë subvencionimin klubeve dhe OJQ-ve.

**Fadil Gashi, kryesues:** ka dy vite që ndarja e subvacioneve bëhet duke u bazuar në rregulloren e nivelit nacional, ne kemi edhe rregulloren tonë por ne duhet ti harmonizojmë këto dy rregullore që mos të bijime në kontest.

**Z. Skender Merturi, drejtor i DKRS:** Unë pajtohem me Enverin se ndoshta është shumë e vogël por këto janë mundësit buxhetore që ne kemi në dispozicion. Ne na ndalon qe ti subvencionojmë me thirrje për arsyet se nuk kemi pranuar raport kthyes nga shoqatat, nga thirrja publike janë përjashtuar shtatë OJQ për shkake se nuk kanë pasur raport kthyes. Këtu nuk përfshihen shoqatat sepse nuk kanë aplikuar, fjalë është për disa të tjera. Ne kemi biseduar dhe me auditor të jashtëm dhe ata na kanë propozuar qe ti subvencionojmë përmes Kuvendit nëse Kuvendi vendosë. Në fund vendos asambleja dhe ne do ta respektojmë vendimin e asamblesë.

**Z. Enver Berisha:** Drejtor nga ato gjashtëdhjetëmijë euro sa janë shpenzuar deri me tani dhe sa janë në dispozicion?

**Z. Skender Merturi, drejtor i DKRS:** Ka përfunduar thirrja publike dhe janë subvencionuar klubet dhe OJQ-të, kemi ndarë disa mjete rezervë pikërisht për këto shoqata që tua ndajmë përmes Kuvendit.

**Z. Tunë Dedaj:** Unë i pashë kërkesat, diçka qe me ra në sy ishin aktivitetet apo vizitat jashtë vendit, s'po di se a kanë aktivitete jashtë vendit apo jo! Dhe po ashtu jepim arsyetim festivalin "I Këndojmë Lirisë" dhe unë e di se për organizimin e këtij festivali parat ndahen nga Kuvendi për organizimin dhe shpenzimet e festivalit.

**Z. Enver Berisha:** Këto shoqata në fakt kanë koordinim me Kroacinë dhe Maqedoninë por edhe Shqipërinë, për shkake të rr Ethanave të kohës që ka pasur Kroacia dhe Maqedonia me shumë luftëtar dhe të ram dëshmorë atje, kjo është arsyja që në shumë përvjetor dhe shumë aktivitete të tjera duhen të jenë në vizita jashtë vendit.

Ndërsa për festival e dimë se nuk është mbajtur, por këta kanë ber aktivitete si vendosje të kurorave dhe vizita të ndryshme, këtu është arsyja dhe mendoj se duhet të rekomandohet për kuvend.

**Fadil Gashi, kryesues:** Atëherë nëse të gjithë pajtoheni ne po e rekomandojmë për Kuvend. Kryesuesi vuri në votim dhe me 5-së vota PËR, Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që kërkesat e parashtruara nga Shoqatat e Familjeve të Dëshmorëve të UÇK-së, Veteranëve të Luftës së UÇK-së dhe shoqata e Invalidëve, të dërgohet për shqyrtim në Kuvend.

#### Kërkesa nr. 6:

Kërkesë e parashtruar nga drejtoria për Financa Ekonomi dhe Zhvillim, kërkesë për ndarje të mjeteve financiare në shumë prej 50.000.00 Euro për Klubin e Futbollit "Dukagjini" pasi që tani gjendet në Superligën e Kosovës.

- Kodi 16018 vlera prej 10.000.00 Euro
- Kodi 47018 vlera prej 25.000.00 Euro
- Kodi 85018 vlera prej 10.000.00 Euro
- Kodi 92090 vlera prej 5000.00 Euro
- Totali në vlerë prej 50.000.00 Euro

**Z. Fadil Gashi, kryesues:** unë po hapi debat sa i përket kësaj kërkesë!

**Z. Enver Berisha:** Po, parmisht unë jam pro kësaj kërkesë, vetëm po dua t'ju bëj me dije drejtorit dhe të tjerëve se aty ku ka vullnet dhe interesim mund të gjendet përkrahja, është mirë që kur të trajtohet diçka të merret parasysh nevojat dhe të ketë parim dhe drejtësi.

**Z.Tunë Dedaj:** Unë duke marrë parasysh suksesin të cilin e kanë korrë klub i futbollit Dukagjini, dhe qe i kanë ber krenar të gjithë qytetaret e komunës sonë, e përkrahi ketë kërkesë që të ju ndahet kjo shumë ashtu siç kanë kërkuar.

**Z. Enver Berisha:** Nuk e di shuma të cilën e kemi ndarë për Festivalin “I Këndojmë Lirisë” a është ridestinuar apo qëndron ende ashtu e pa shfrytëzuar, nëse ka mundësi Ajeti të na sqaroj.

**Z. Ajet Sejdiu:** Po, ajo shumë është ridestinuar në renovimin e kullës në Çabiq.

**Z. Enver Berisha:** Unë kisha kërkuar qe të shikohet se nëse ka mjete të pa shfrytëzuara nga ajo shumë të ju ndihmohet shoqatat e dala nga lufta.

**-Pas përfundimit të debatit, Kryesuesi vuri në votim dhe me 5-së vota PËR, Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që kërkesa e parashtruar nga drejtoria e F.E.ZH. Për ndarje të mjeteve në shumë prej 50.000.00 Euro klubit të futbollit “Dukagjini” të kaloj për Shqyrtim dhe miratim në Kuvend.**

Kryesuesi vazhdoj me prezantimin e kërkesave me radhë:

**Kërkesa nr. 7:**

Kërkesë e parashtruar nga Klubi i Volejbollit të Femrave KVF “Dukagjini” për mbështetje financiare në shumë prej 10.000,00 Euro, po ashtu për dhënie të fjalës në Kuvend për arsyetimin e kërkesës në fjalë.

**Z. Fadil Gashi ,kryesues:** Unë duke u bazuar në ligjin për vetëqeverisje lokale rregulloren për punë të kuvendit dhe atë për transparencë, unë do ti jap fjalën në Kuvend sa i përket kësaj pike ashtu siç ka kërkuar, pastaj do të marrim vendim sa i përket kërkesës.

**Z. Skender Merturi, drejtor i DKRS:** Klubi i Femrave KVF “Dukagjini” nuk i ka 50 femra ashtu siç e ka shkruar në kërkesë. Ky klub ka fituar vendin e parë por prap ka mbetur në të njëjtën lig, pra në ligën e parë. Ky klub është subvencionuar edhe në thirrjen publike në shumë prej 2000 euro.

**Z. Enver Berisha:** Unë realisht jam në ngjarje sa i përket kësaj kërkesë sepse kam biseduar edhe me Zonjushën Lazri, unë jam i shqetësuar kur e shoh se si drejtori nuk i gjëzohet një suksesi të një klubit të femrave! Po ashtu këtij klubit edhe në vitin 2018 ju kanë nda nga Kuvendi 4000 euro dhe vetëm 2000 ju kanë, dhen ndërsa pjesa tjetër jo. Nëse për një klub që ka hyr në superlig po bejka mi nda një shumë prej 50.000.00 euro si s'bën të ndahet një shumë prej 10.000.00 për një klub qe e ka mbërrri majën e asaj gare! Prandaj ne duhet të ndryshojmë qasje, unë kërkoj ta rekomandojmë për asamble dhe kërkoj nga grupet parlamentare ta përkrahim kështu siç ka kërkuar.

**Z. Skender Merturi, drejtor i DKRS:** Ne gjithsesi i gëzohem sukseseve të klubeve por edhe suksesit të këtij klubit. Por unë nuk pajtohem me kërkesën dhe arsyeshmërin të cilën e ka jap klubit këtu.

Ne do ta respektojmë vendimin e asamblesë gjithsesi. Ky klub ka fituar vendin e parë dhe do të mbetet në të njëjtën ligë dhe prap do ti vazhdoj të njëjtat lojë siç e ceka dhe me lartë.

**Z.Tunë Dedaj:** Unë mendoj se e meritojnë qe t'i ndihmojmë, faji këtu është i ministrisë sepse me fitu vendin e parë dhe me mbet po në të njëjtën ligë po me duket absurditet, prandaj të shikohen mundësit dhe ti ndihmohet aq sa ka mundësi. Por këtu duhet të merren parasysh edhe shpenzimet në mes të klubit të Dukagjinit i cili ka hyr në superligë sepse ata kanë shpenzime të tjera ndërsa këta kanë shpenzime me te vogla.

**Z.Fadil Gashi ,kryesues:** Unë personalisht jam qe t'i ndihmohet ashtu siç ka kërkuar. Mendoj se është mirë qe t'i ndihmohet sepse nuk është faji i tyre se kanë fituar vendin e parë dhe kanë mbetur në vendin e parë. Dhe nëse e përdorim një kriter ta përdorim të njëtin kriter për të gjithë.

**Z. Skender Merturi, drejtor i DKRS:** Duke e përjashtuar këtu klubin "Dukagjini" unë kam frik se nëse e miratojmë ketë kërkesë, do të kemi kërkesa të tjera nga klubet sportive dhe me pas nuk do të mundem të ju dalim në ndihmë të gjithave.

**Z.Fadil Gashi ,kryesues:** Ne nëse nuk i rekomandojmë 10.000.00 euro për shoqata, i rekomandojmë 50.000.00 euro ndarje për klubin e futbollit "Dukagjini" E klubit në fjalë nuk ja rekomandojmë ndarjen prej 10.000.00 euro, cili është trajtimi i cili ne po ju bëjmë, prandaj nuk duhet t'u hymë në hak asnjërs, duhet ti trajtojmë barabartë.

**Z. Skender Merturi, drejtor i DKRS:** Ne edhe po deshëm nuk mundem ti trajtojmë barabartë klubet sportive, prandaj kemi ber thirrjen publike dhe komisionin për ndarje të subvencioneve dhe po ashtu ka qenë edhe komisioni i ankesave i cili i ka shqyrtau të gjitha ankesat. Në fund të fundit asambleja le ta përkrah ndërsa ne do ti ndihmojmë me aq sa mundësi sa kemi.

-Pas përfundimit të debatit, kryesuesi i Komitetit z. Fadil Gashi vuri në votim dhe me 5-së vota PËR, Komiteti për Politik dhe Financa, rekomandoj që fillimisht ti jepet fjala në Kuvend ashtu siç ka kërkuar, pastaj të shqyrtohet kërkesa e parashtruar për mbështetje financiare të Klubit.

#### Pika 5. Të ndryshme

-Pasi nuk kishte diçka tjetër për të debatuar, kryesuesi theksoj se me kaq po e mbylli mbledhjen e rregullt të Komitetit për Politik dhe Financa.

Gjithashtu falënderoj të gjithë për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:30

Procesmbajtësi,

Ahmet Berisha



Kryesuesi,

Fadil Gashi